



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A.
Kosovo Landfill Management Company J.S.C
Rr. Sheshi i Lirisë, p.n. Fushë Kosovë 12000, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren Nr. 01/2024 Për Kriteret dhe Procedurat e Punësimit në KMDK Sh.A., Rregullores Nr. 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës në KMDK Sh.A, bazuar në Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK Sh.A Nr. 06/2025 të dt. 10.01.2025 me nr. të protokollit 02-06/06, KMDK SH.A shpall këtë:

KONKURS PUBLIK PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli: Menaxher i Sistemit të Cilësisë, 1 (një) pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-1-2025

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv

Niveli i pagës: Niveli III, 974.61 (nëntëqind e shtatëdhjetë e katër € e gjashtëdhjetë e një cent) në muaj

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi, puna provuese zgjatë tre (3) muaj

Vendi i punës: KMDK-së SH.A.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Të përcaktojë, ndërtojë dhe zbatojë sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- Të mirëmbajë dhe të bëjë efektiv sistemin e menaxhimit të kullatitetit në KMDK SH.A.
- Të sigurojë përputhshmërinë e sistemit të kualitetit të KMDK-së me ISO 9001:2015.
- Të sigurojë konsistencë të sistemit të menaxhimit të kualitetit në KMDK.
- Të sigurojë që mesazhi mbi kualitetin është transmetuar në Kompani dhe të jetë i kuptuar nga të gjithë.
- Të ndihmojë dhe këshillojë për sistemin, matjen dhe rishikimin e proceseve të brendshme, veçanërisht ato që ndikojnë në cilësinë e menaxhimit dhe shërbimeve të KMDK-së.
- Të ndihmojë ekipin e kualitetit në fushën e inxhinierisë-operative, kontrollës së brendshme të sektorit analitik.
- Këshillon menaxhmentin për marrjen e veprimeve përmirësuese në SMC.
Kryen detyra të tjera shtesë sipas ligjeve në fuqi që ndërlidhen me pozitën e caktuar.

Kualifikimet dhe përvoja e punës

- Diplomë Universitare, (katër vjeçare) ose niveli Master.
- Të ketë 4 vite përvojë pune në udhëheqje.

Aftësitë kryesore

- Të demonstrojnë aftësi të jashtëzakonshme të komunikimit me gojë dhe me shkrim.
- Gatishmëri në përmbushjen e misionit, vizionit dhe qëllimeve operative të kompanisë.

Procedura e konkurrimit:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>.

Dokumentacionin mund të paraqitet në mënyrë elektronike, nëpërmjet Emailit: kmdkpunesime@gmail.com, përmes postës ose në kopje fizike në zyrë e Burimeve Njerëzore në adresën: Rruga Sheshi i Lirisë, p.n Fushë Kosovë 12000, Kosovë (ish objekti i NP "Trainkos"), Tel: 038 600–552.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe adresën email-it.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Aplikacioni
- CV
- Diploma/t
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësive
- Certifikatë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i/e dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit).

Mënyrat e vlerësimit dhe kriteret e poentimit

Vlerësimi i aplikimeve të konkursit publik në KMDK përmban gjithsej njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë (50) pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik. Kriteret e poentimit: jetë përshkrimi (CV) e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë, testimi me shkrim deri në gjashtëdhjetë (60) pikë dhe intervistimit deri në tridhjetë (30) pikë.

***Shënim:** Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tre (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.*

Afati për aplikim është deri me datën 24.01.2025 në orën 16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A.

Email: kmdkpunesime@gmail.com

Tel: 038 600–552.